# DËSHMI ARKIVI

**A-472487**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Paketa e Maleve është për pronarët”, Rama në SHBA: Zvërneci sjell 4 miliardë euro, po studiojmë ndikimin dhe riskun në mjedis |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/26/paketa-e-maleve-eshte-per-pronaret-rama-ne-shba-zverneci-sjell-4-miliarde-euro-po-studiojme-ndikimin-dhe-riskun-ne-mjedis/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 19:20:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 19:10:10 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8bc1b19da1d771eb8b8e6636d711fad7ad1fb9e41ca7d7a504df391b049c0095` |
| TEKSTI | `4d6da4f9b97f1797ef6e118b799da528a5c31a6e449cf20581594eddf71697c6` |
| PAMJA | `fea21ddd0702607e1275aa1db2c28650b41baafe226e9c8e645ca4e3a321ce90` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1c2b8210f6576708697db69a6add1337fdc00744e8634ed3968f7528516c457a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1c2b8210f6576708697db69a6add1337fdc00744e8634ed3968f7528516c457a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Paketa e Maleve është për pronarët”, Rama në SHBA: Zvërneci sjell 4 miliardë euro, po studiojmë ndikimin dhe riskun në mjedis

Politikë

Publikuar: 26/09/2026



Në një takim me shqiptarët në Staten Island të New York, kryeministri Rama ka folur për rëndësinë e Paketës së Maleve dhe për Zvërnecin, një projekt që vijon të jetë shumë i diskutuar dhe për të cilin Rama konfirmon se puna vazhdon dhe po studiohet ndikimi në mjedis.

“Paketa e Maleve është bërë për të gjithë ata që kanë pronën atje dhe asnjë investitor tjetër nuk do të ketë akses nëse nuk është partneri juaj dhe nuk është dëshira juaj për ta pasur atje. Kush dëshiron të ketë një partner, është i mirëseardhur.

Kthimi i maleve në një burim mirëqënieje është një burim i rëndësishëm ëpr ta çuar përpara Shqipërinë. Synimi është që nga 12 milionë vizitorë në Shqipëri, është ta çojmë në 20 milionë. Më pas detyra është e të rinjve që do të marrin stafetën që ta çojnë më lart. Tashmë synimi është që në Shqipëri të sjellim turistin me të ardhura të larta.

Këtë synim ka edhe projekti i shumëdiskutuar, i famshëm, por edhe famëkeq si rezultati i shumë gënjeshtrave, manipulimeve dhe politik, Zvërneci dhe Sazani. Ky projekt sjell 4 miliardë euro në një ekonomi që në total është 27 miliardë euro.

I jashtëzakonshëm për Shqipërinë, por edhe delikat në ekuilibër në mjedisin dhe po punojmë shumë për të studiuar impaktin dhe për të kuptuar risqet reale dhe jo ato që prodhohen në rrjetet sociale nga manipulatorët dhe sharlatanët. Ditët e punës këtu kanë pak kafe dhe për më tepër atë kafen e tmerrshme amerikane, ndryshe nga Shqipëria.

Ju falënderoj për kohën që ju mora në këtë ditë pushimi.

Më të lexuarat


33-katëshi në Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me “grupin e kokainës” për “Kullën e Tiranës”



40 milionë euro tendera / Kush është fierakja Diana Laba që vjedh paratë e bashkive me punime fik...


Porti i Durrësit drejt zhvendosjes, por Liburn Ali nuk ndalon tenderat, miliona euro për godinat...


U arrestua me urdhër të SPAK, kush është “i forti” i Shkodrës! (Emri)


“Shkova bashkë me Argitën” – E akuzoi se ka kaluar nga zyra e Agasit, Berisha &...

Falënderoj Xhemon që është veshur si politikan amerikan, unë para teje ngjaj si roja i hotelit. Të falënderoj shumë për organizimin. Bashkë me ty janë edhe disa djem nga Ulqini, shumë faleminderit.

Nëse burrat e Shqipërisë kanë bërë shumë budallallëqe, imagjino ç'do të bënin po të mos kishin gratë, prandaj ju falënderoj edhe juve. Mbajini mirë burrat dhe mos ja vini veshin kur bëjnë si të fortë, sepse në zemër dridhen kur flisni ju. Shumë faleminderit", u shpreh Rama.

TAG: Edi rama

## Të ngjashme



**"Na ndërpreu takimin dhe mallkoi banorët", Braçe reagon pas përplasjes me aktivisten**



**Komisioni Hetimor për zgjedhjet e 11 majit, PD kërkon nisjen e procedurave: Vendimi i Kushtetueses është detyrues**



**Wendt në Tiranë, ambasada amerikane zbardh detaje pas takimit me Begajn: Diskutuan për çuarjen përpara të përparësive të administratës Trump**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë



Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena
Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.